REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Br.str. 361
Datë/Datum 10. 11. 2026
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e shtatë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 30.07.2026, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës. h

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Etnik Berjani, Rrahim Tërnava, Valon Murseli, Ermal Dumani, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Aida Alimi, Suhat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Gjelbrim Halili, Ali Ismaili dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Ali Topalli.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Valon Prebreza - Kryetari i Komunës, Bardhyl Koicici - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Albana Gashi - Drejtoresha për Shëndetësi, Sabri Xhigoli - Drejtor i Arsimit, Ylber Klemendi - Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport, Durim Hajra - Drejtor i Inspektoratit, Arianit Tërmkolli - Drejtor i Infrastrukturës, Mirsad Qyqalla - Drejtor i Bujqësisë.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 30.06.2026.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
4. Propozim për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.
5. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar - Qershor 2026.
6. Propozim për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar- Qershor 2026.
7. Propozim për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026.
8. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar kolegë të kuvendit komunal, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor dhe ju të pranishëm, ju falënderoj për pjesëmarrjen, po e hapim mbledhjen e shtatë të Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës, dje në mbledhjen e Komitetit për Politkë dhe Financa, pasi që kemi diskutuar pikat kanë ardhur edhe dy rekomandime nga Ekzekutivi i Komunës. Unë po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës: pika e parë është: Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë

Kosovës e datës 30.06.2026, pika e dytë: Pyetje dhe përgjigje parlamentare, pika e tretë: Propozim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, pika e katërt: Propozim për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore, pika e pestë: Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026, pika e gjashtë: Të ndryshme dhe pikat shtesë të cilat kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa janë: Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, dhe Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, pajtohemi me pikat e rendit të ditës dhe pikat shtesë.

Laureat Gojnovci: Përshëndetje kryetar i komunës, drejtor, anëtarë të kuvendit dhe ju të pranishëm, sa i përket rendit të ditës që ka ardhur nga ekzekutivi e përkrahim, ndërsa sa i përket pikave shtesë, propozimi lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës, sipas drejtorit kërkesa ka qenë më datë 18.07.2026, drejtori ka pasur kohë ta inkorporoj si pikë të rregullt, parimisht e përkrahim sepse është projekt i mirë, por ju lutem mos të sjellni pika jashtë rendit të ditës, sepse është bërë praktikë, ndërsa propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026, nuk e përkrahim për faktin se po anulohet një projekt për fshatrat Miradi e Epërme, Sllatinë e Madhe dhe Fushë-Kosovë.

Migjen Kolshi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, sa i përket rendit të ditës ne i përkrahim pikat e rregullta, ndërsa pikat shtesë jo për arsye se është bërë praktikë e keqe, që në secilën mbledhje, po kemi pika shtesë.

Ali Ismaili: Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryetar, kryesues, kolegë dhe ju të pranishëm, e mbështes rendin e ditës ndërsa pikat shtesë nuk i mbështes, sepse asambleisti pa i shqyrtuar këto pika nuk mund të jap kontributin e tij, ju keni qenë kritik i madh ndaj meje sidomos kur kam qenë kryesues, por tani kaluan gjashtë mbledhje dhe prapë po vazhdojmë me ritmin e njejtë, e keni sjellë një pikë të rendit të ditës njejtë si në të kaluarën, me një kërkesë të një individi, një Organizate Jo Qeveritare, po dojmë me i'a jap 2100m2, Ngastën Kadastrale, që na keni dhënë në material shihet se janë diku 8 hektarë tokë, a keni ndarë me kadastër apo si? Në komitet nuk na u tha se kush do ta financoj, ne si asamblesitë duhet të kemi të gjitha emailat e bashkëpunimit për këtë projekt. Sa i përket propozimin për ridestimin e mjeteve financiare, varrezat janë shumë keq në Miradi të Epërme, dhe jam kundër kësaj pike të rendit të ditës, është mirë të bëhen rrethojat në varreza, sepse kemi folur shumë për këtë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit Ali, nëse nuk ka të tjerë po i qesim në votim dy pikat që kanë ardhur rekomandim nga Komiteti për Politikë dhe Financa, pika e parë është 'Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e shtatë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në bazë të votimit konstatoi se hyn në rend të ditës për shqyrtim kjo pikë dhe propozimi tjetër është: Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

U votua me: njëzet e katër vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në bazë të votimit konstatoi se hyn për shqyrtim në rend të ditës kjo pikë.

Po e qesim në votim rendin e ditës së bashku me dy rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa.
U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u miratua rendi i ditës së bashku me dy rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 30.06.2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, aprovimin e Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës te datës 30.06.2026. Hapi diskutimin.
Kosovar Ademi: Pajtohemi me përmbajtjen e ekstraktit.
Laureat Gojnovci: Nuk e përkrahim.
Valon Murseli: E kam përcjellë vërejtjen me shkrim.
Ali Ismaili: I kam dy vërejtje, e para është gjithmonë keni menduar me rregulluar këtë pjesën e ekstraktit, e të mos ngarkohet zyrtari me 50 faqe, e dyta në 4-5 pika në këtë ekstrakt, figuron që unë nuk kam folur fare, sepse u dakorduam të shkojmë në pauzë dhe unë dola në korridor, sepse me thanë që mbas pikës që ishte duke u trajtuar, e kemi pauzën dhe unë duke pritë që po përfundon pauza, më treguan që kishte përfunduar mbledhja. Nuk kam mundur të flas fare për rregulloret, kam pasur disa kritika dhe ato kanë kaluar, e kam bërë një shkresë dhe e kam dërguar në Ministri, sepse vërejtjet e mia nuk arritur në Kuvend, sa i përket Rregullores së subvencioneve.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili, ajo që e the ti është përceptim i gabuar, sepse t'i ke vendosur ta lëshosh mbledhjen, nëse ne kemi thënë që do mbajmë pauzen, ne kemi pasur plan ta mbajmë pauzën se bashku më të gjithë anëtarët e Kuvendit, t'i nuk ke qenë prezentë, nëse do ishe do ta jepnim fjalën pa asnjë problem, këtë vërejtje mbaje pak për vete dhe ju lutem të keni respekt për njëri tjetrin në fjalor.
Ali Ismaili: T'i nuk kupton gjuhë të mirëkuptimit, t'i kupton vetëm gjuhë zyrtare, është mirë ta pranosh se je dal në koridor, më keni pyetur, a kthehesh se po marrim pauzë dhe të kam thënë që po, ju nuk më keni informuar fare që Kuvendi, ka vazhduar me pikat e tjera, pauzën e kam marrë për arsye të portaleve tuaja. T'i po gënjen kur thua, se e kam lëshuar mbledhjen.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju Ali Ismaili, e keni lëshuar mbledhjen, po e qesim në votim 'Aprovimin e Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës të datës 30.06.2026'.
U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për' asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej shtatëmbëdhjetë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se u votua me unanimitet të pjesëmarrësve në votim 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datë 30.06.2026', me përmirësimet e cekura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani fjala është për ju asambleistë.

Laureat Gojnovci: Faleminderit kryesues, prej fillimit të mandatit si Grup parlamentarë, kemi bërë thirrje që të ruhet gjuha e komunikimit, gjë që nuk kemi pasur mirëkuptim nga ana e Ekzekutivit të Komunës dhe si pasojë e kësaj jemi detyruar të lëshojmë sallën e Kuvendit në mbledhjen e kaluar, prej Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk do keni asnjëherë ofendime ose etiketime, por vetëm do të bëjmë pyetje dhe kërkesa të qytetarëve. Pyetjen e parë e kam për Drejtorin e Arsimit, procesi i shpërndarjes së bursave nuk i përmbush kriteret minimale, që të trajtohet si i rregullt, mungesa e transparencës së përfituesve të bursave, drejtori tha se kanë tepruar mjete financiare dhe si pasojë kanë përpiluar një listë tjetër, që të përfshihen të gjithë, ndërsa studentëve po ju thuhet që s'ka mjete financiare deri në fillim të muajit gusht, a keni mjete financiare apo jo? Në thirrje te kriteret është nënshkrimi i kontratës, ndërsa studentët nuk kanë nënshkruar kontratën, a ka gabime teknike? A është e drejtë të marrim këtë ndihmë studentët që i kanë dy nota? Pyetja e dytë, është për Drejtorin e Planifikimit Urban, shumë afër komunës është duke u ndërtuar një Xhami, titullari i pronës është Agjensia Kosovare e Privatizimit, a është duke u zhvilluar ndonjë procedurë, kush do të lëshoj lejen ndërtimore, a keni memorandum me Bashkësinë Islame dhe Agjensinë Kosovare të Privatizimit? Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, pse varrezat në Komunën e Fushë-Kosovës, nuk po pastrohen për gjashtë muaj? Kryetar pse vendimi për sindromin doën dhe autizëm, mjetet financiare do t'i marrin nga korriku deri në dhjetor, jo nga periudha kur është marrë vendimi? Renovimi i shkollave, është kodi 20867, që janë 270,000.00€, a keni filluar me renovimin e tyre pasi që nxënësit janë në pushim? Kryetar kur pritet të lëshohen mjetet financiare për vërshimet për banorët e Fushë-Kosovës, me sa kamionë keni pretenduar, që kompania private do të operoj për grumbullimin e mbeturinave, në fillim sa keni thënë që janë dhe sa janë aktualisht? Për Drejtoreshën e Shëndetësisë, pse nuk po ekzektuohet pagesa prej 150.00€, për mjekët e Fushë-Kosovës, që është një vendim prej Ministrisë së Shëndetësisë?

Migjen Kolshi: Pyetjen e parë e kam për Kryetarin e Komunës, ka të bëjë me tenderin 1,100,000.00€, për pompat termike, gjatë fushatës keni premtuar që ngrohja e qytetit do të realizohet nga KEK-u, nëse realizohet ky premtim këto 1,100,000.00€, do të humbin, a do të ishte më mirë që këto mjete financiare të shfrytëzohen për lidhjen e infrastrukturës me KEK-u? Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike, na keni thënë se kompania do të punoj me 4 kamionë, në bazë të informatave që kam ajo punon me 3 kamionë? Pyetje për tenderin hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për Komunën e Fushë-Kosovës, i është dhënë kompanisë 'DEA GROUP' Sh.p.k, vlera e projektit ka qenë 150,000.00€, komuna ka punësuar shumë punëtor, a nuk keni marrë kuadro që të bëjnë projekte? Pyetje për Drejtorin e Arsimit, a jeni në gjendje të vazhdoni punën si Drejtor i Arsimit, me të gjitha këto probleme, që i kemi në Drejtorinë e Arsimit në komunën tonë? Pyetje për Drejtorin e Kulturës, në bazë të asaj që pashë tek raporti financiar gjashtëmujorë për vitin 2026, janë 215,000.00€, të ndara për fazën e dytë të stadiumit, 135,000.00€, janë të alokuara, ku është projekti apo jeni duke keqëpërdorur në mënyrë të ligjshme, çfarë do të ndodhë më këtë projekt, sepse kompania ka filluar procedurat gjyqësore ndaj Komunës së Fushë-Kosovës.

Ali Ismaili: Përshëndetje për të gjithë, i nderuar kryetar, kryesues, pyetje për Drejtorin e Planifikimit Urban, çka po ndodhë me Planin Zhvillimor Komunal, në cilën fazë ndodhet aktualisht, a do të përfundoj dhe miratohet brenda këtij viti, a janë adresuar vërejtjet e dhëna nga institucionet kompetente? Për Drejtoreshën e Administratës, sa ka shpenzuar Komuna e Fushë-Kosovës, për karburante gjatë shtatë muajve të fundit, sepse disa automjete zyrtare qëndrojnë në

rrugë edhe orëve të vona? Sa i përket Xhamisë, ne kemi ndërtuar edhe shkolla pa leje, unë gjithmonë do t'i mbështesë ndërtimet e xhamiave dhe shkollave. Vajza ime ka marrë bursë në arsim, sepse ka plotësuar kriteret, mos mendoni që nuk kemi të drejtë të përfitojmë, është mirë të vendosni kriteret drejtor, sepse është akuzuar Drejtoresha e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, prej portaleve të ndyta, ajo vjen nga një familje veteranë të luftës dhe keni 15 pikë për këtë kategori, ka dy mastera, ka marrë bursë në kohën e z. Burim Berishës, nga z. Albin Kurti, nga ju dhe do të marrë prapë, sepse ligji e lejon.

Aida Alimi: I nderuar kryetar i komunës, i nderuar kryesues, të nderuar kolegë asambleistë, drejtor dhe ju të pranishëm, pyetja ime e parë është pse nuk po respektohet 'Rregullorja e transparencës në kuvendin komunal të Fushë-Kosovës', nuk kemi audio-incizim, nuk dihet se çka flasim ne në këtë Kuvend, po ashtu i kërkojë Kryesuesit të Kuvendit të bëjë 'Planin e transparencës' dhe deri në fund të vitit ta harton 'Rregulloren e transparencës', mikrofonët për shtatë muaj nuk janë funksional, po ashtu nuk kemi, as karta të identitetit, që jemi këshilltarë në Kuvendin e Fushë-Kosovës, nuk i kemi emërat para vetës, këto janë probleme minore, të cilat duhet të rregullohen. Problem permanentë në komunën tonë janë qenët endacak, çfarë hapa keni ndërmarrë për largimin ose sistemimin e tyre? Kërkojë që të rregullohet një zyrë për ata që do të kurorëzohen në Komunën e Fushë-Kosovës, po ashtu kam dhe një pyetje për Komisionin për emërimin e rrugëve, nga kjo foltore është diskutuar, që unë s'kam punuar asgjë, janë raportet për punën që kanë bërë për katër vite, unë deshta të dijë sa takime ka mbajtur ky komision, deri ku kanë shkuar zhvillimet e punimeve të këtij komisoni?

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë dhe ju të pranishëm, i kam disa pyetje për Drejtorin e Arsimit, bartja e stafit nga komuna në arsim, a kanë profesionin ky staf për t'i dërguar në arsim, disa profesorëve me 'Kosova Med', ju ka vazhduar kontrata dhe disave jo, do të ishte më mirë, që ata të vazhdonin punën se sa të bëhet bartja, mirëpo nëse bëhet, a do ta shpallni konkursin. Drejtori i Shërbimeve Publike, a na tregon neve një projekt që të bindemi se sa është shuma në secilin fshat për rregullimin e kanalizimeve, kryesues sot nëse e voton këtë bartje pa rrethoja të varrezave të Miradisë, sot do ta bëjë foto që po e tradhton Miradinë e Epërme, sepse katër vite keni kërkuar këto rrethoja. Për Drejtorin e Infrastrukturës, rruga për tek pishat, a ka planifikim të zgjerohet, sepse qarkullimi për dy automjete është shumë i ngushtë dhe trotuaret prej pishave deri te shkolla kur keni planifikuar të fillojnë punimet? Në rrugën 'Tahir Zemaj', a keni planifikuar rregullimin e ndriçimit publik? Për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, vajza ime luan volejboll dhe e kam dërguar deri në oborr të shkollës, turnirin që e keni mbajtur veshjet nuk kanë qenë adekuate për volejboll.

Valon Murseli: Përshëndetje kolegë dhe ju të pranishëm, ju njoftoj se në emër të Grupit të asambleistëve të Partisë Demokratike të Kosovës, kam paraqitur tri kërkesa te Auditori i Brendshëm, një kërkesë është për projektin e pompave termike, kërkesa tjetër është për digjitalizim në objektet shkollore dhe auditim të bursave momentale të cilat janë dhënë, besoj dhe shpresoj në punën e auditorit për të marrë një opinion mbi gjetjet për këto tri procese. Në specifikime teknike ka shumë tendencë për të larguar konkurencën, nga analiza e projektit për pompa termike të cilat planifikohen të instalohen në shkolla, ka dyshime për kufizim të konkurencës dhe favorizim të produkteve të caktuara, qytetarët meritojnë të dinë mbi çfarë baze ligjore dhe teknike është rritur vlera e projektit nga 800,000.00€ në vlerë 1,100,000.00€, ku ky projekt nga kjo legjislaturë në mbledhjen e tretë është rritur nga 300,000.00€, në 800,000.00€, pra është rritur vlera e projektit, a

ka zotim të mjeteve financiare, për këtë projekt dhe si është nënshkruar deklarata e nevojave, nëse nuk ka buxhet për këtë projekt? Gjetjet në këtë tenderë janë evidente të gjetura nga profesionistë nga Dega e Partisë Demokratike e Kosovës, elementet që ngrehin dyshime janë: përputhja po thuaj se e plotë e specifikimit me modele të caktuara të prodhuesve, përcaktimi i dimensioneve, peshës dhe karakteristikës identike me produkte konkrete, pa qenë të domosdoshme për funksionalitetit e këtij projekti, përdorimi i kodeve dhe emërtimeve të sakta të produkteve, duke evidentuar prodhues të caktuar, mungesa e tolerancës teknike, duke kufizuar ofertimin e produkteve ekuivalente, përdorimi formal i termit 'ose e ngjashme' dhe disa kritere tjera që praktikisht pamundësojnë konkurencën reale, specifikimet e hartuara mbi karakteristikat e një produkti konkret dhe jo mbi nevojat profesionale të projektit. Konkluzioni i përgjithshëm i dokumentit në të gjitha pozicionet e analizuara vërehet një model i njejtë, specifikimet teknike janë hartuar mbi karakteristikën identifikuese, modele, kode tregtare, dimensione, peshë dhe parametra specifike në vend të kërkesave profesionale, kjo krijon dyshime të bazuara për koeficientë artificial të konkurencës, favorizim të prodhuesve të caktuar dhe shkeljeve të parimit të Ligjit mbi prokurimin publik dhe Rregullores për prokurim publik. Sipas informatave ky projekt është anuluar, por kjo nuk e kalon tendencën për këtë projekt, gjetjet e dyta që kërkojë të identifikohen nga auditori janë: kufizim i konkurencës, të verifikohet respektimi i neneve 4.3 dhe 17, të Rregullores së prokurimit publik, pasi që në projekt rreth 900,000.00€, janë pranuar vetëm dy oferta, të verifikohet respektimi i neneve 13.2 dhe 18, të Rregullores së prokurimit publik, pasi në një tenderë janë bashkuar trajtimi dhe mirëmbajtja, specifikime teknike potencialisht kufizuese, të verifikohet respektimi i neneve 19.4 dhe 19.6, të Rregullores së prokurimit publik, përkatësisht nëse kërkesa teknike ka favorizuar produkte apo operator të caktuar, kërkesat për tri standarde Iso, të verifikohet proporcionaliteti i tyre sipas nenit 25.17, të Rregullores së prokurimit publik, kriteret ndaj grupit të operatorëve ekonomik të verifikohet, respektimi i neneve 26.5 dhe 26.8, të Rregullores së prokurimit publik, kërkesa e lartë për staf professional të verifikohet, nëse ekziston analizë që arsyeton numrin dhe profilet e kërkuara, apo këto kritere kanë kufizuar konkurencën, vlera reale e projektit, të bëhet vlerësim i pavarur teknik dhe financiar për koston reale të projektit, sipas analizës së projektit, vlerësohet se në kushte normale të tregut mund të kushtojë rreth 350,000.00€, këto vlerësime paraqesin tregues serioz, se ekziston një mos përputhje e konsiderueshme ndërmjet përceptimit të tregut dhe vlerës së planifikuar nga Autoriteti Kontraktues, për këtë arsye është e domosdoshme të publikohet, analiza e tregut të cilen e keni bërë kur është marrë vendimi për buxhetim, baza e përcaktimit të vlerës rreth 900,000.00€, rreziku për dëmtim të buxhetit në këtë projekt. Në procesin e bursave që lënë shumë dyshime për keqëpërdorim të parasë publike dhe detyrës zyrtare, me cfarë të drejte certifikuesi dhe Drejtori i Financave, aprovon pagesën për këtë proces kur një nga kriteret kryesore në këtë thirrje, është që do të ketë një kontratë mes studentit dhe komunës, kjo nuk është bërë, po ashtu është bërë pagesa pa u publikuar lista zyrtarisht, do kërkoja nga financat të di kodi 22202, a është shpenzuar në muajin qershor, për këtë kategori? Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë, pse 1218 fermerë po injorohen duke i paraparë në buxhet vetëm 100,000.00€, për këtë kategori në vitin 2027, ku mund të përfitojnë vetëm 20-30 fermerë, përmes paisjeve bujqësore, ku është pjesa tjetër, që mund të ndihmohen me subvencionim të drejtëpërdrejtë? Të gjithë e dimë se në disa objekte banesore ka dëmtim, rënie të fasadave, gjë që ju kam drejtuar edhe Drejtorit të Inspektoriatit, të cilët kanë marrë veprime të menjëherëshme, a është mirë të bëhet një skanim i gjendjes, sepse mund të rrezikohet jeta e qytetarëve dhe e pronës, po ashtu një premtim që ka dhënë

kryetari për lagjen 'Apollonia', për vendosjen e ashensorëve që nuk është përfshirë në buxhet, po ashtu një premtim që është bërë për lagjen 'Britania Home', për vërshimet në këtë pjesë a keni ndërmarrë ndonjë veprim?

Vjosa Kida Hyseni: Përshendetje për të gjithë, pyetje për Drejtorin e Arsimit, dua t'i shoh listat që kanë dalur me kritere dhe vetë ta shoh, se çka ka ndodhur dhe kush janë ata persona që kanë përfituar bursa? E keni bërë nje vendim të ambulanta që është te 'Kompleksi 300', ka qenë një dyqan i bamirësisë, një kontratë tre vjeçare dhe tani keni vendosur ta bëni stacion policor, çka do të bëhet me atë vend derisa të bëhet pikë e stacionit policor, është rritur bari, është mbushur me tesha, ka një pamje të pahijeshme, ju kisha lutur ta rregulloni. Pas orës 16, një makinë 01Z-33-09, është parkuar te çerdhja e fëmijëve, i mori fëmijet, atë person nuk e kam njohur, deshta të pyes, a po shfrytëzohen automjetet zyrtare për nevoja personale? Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë, e dijmë që i ka hapur disa shpallje për mekanizëm, unë i kam sugjeruar të vazhdojë me pagesa direkte, fermerëve po ju intereson, a do t'i marrin prapë ato pagesa që kanë qenë për koshere bletësh, dele, pula e tjera, ky projekt ka pasur ndikim shumë të mirë te fermerët dhe e kish postuar një fotografi që do t'i mbështesë gratë, nuk dijë, si do mundet pasi që në vit i kanë vetëm 100,000.00€, nuk besoj që ka vend, që ja vlen të investohet më shumë se në bujqësi, do doja një përgjigje për pagesa direkte?

Etnik Berjani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mikrofonët ende nuk janë funksional, kryetari ka publikuar një orar dhe ka thënë që ka përfunduar problemi me mbeturina, në atë orar ka qenë dita e premte, që të largohen mbeturinat nga fshati Miradi e Epërme, akoma nuk janë larguar ato mbeturina. Problemi me ujin, kryetari me kryesuesin e patën lëshuar një ventil të ujit, por çka ka ndodhur tash a ka qenë vetëm përkohësisht? Do doja të dija më shumë rreth procesit të bursave, pasi që ka persona që nuk i kanë përfituar dhe tjetra është disa presione, që po bëhen te punëtorët e komunës, sepse po targetohen ata persona që kanë qenë anëtarë të partisë tonë. Turniret e futbollit janë bërë si me qenë turnire të Lëvizjes Vetëvendosjes, kur do ta bëni subvencionin e Organizatave Jo Qeveritare, sepse keni bërë thirrje, kanë nënshkruar klubet kontratë dhe në fund e keni anuluar, janë në gjendje të tmerrshme dhe kanë nevojë për mbështetje.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë, unë jam Sabri Xhigoli, nga java e dytë e këtij muaji jam emëruar Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, ju kërkojë falje, sepse në disa pyetje që u kërkua përgjigje nga unë, jo për të gjitha kam informacione, sepse nuk kam arritur ende t'i marrë. Shumica e pyetjeve ishin për ndihmën momentale për studentët e nivelit bachelor dhe master, thirrja është bërë me datë 01.04.2026, informata ka qenë që duhet të jetë hapur deri me datë 26.04.2026, në ndërkohë janë hasur disa gabime dhe afati është zgjatur deri me 15.05.2026. Në kuadër të thirrjes kane qenë të gjitha kriteret mbi të cilat do të trajtohet cdo aplikues, me datën 15.06.2026, është përcaktuar shuma se për studentët bachelor do të jetë 300.00€, ndërsa për studentët master do të jetë 400.00€, sipas komisionit. Me vendim me Nr. të protokollit 1172, komisioni për shqyrtimin e ankesave për ndihmë financiare ka bërë publike, se gjithsej 353 studentë bachelor kanë përfituar nga 300.00€, ndërsa 97 studentë të nivelit master i kanë përfituar nga 400.00€, është bërë publike një listë. Në ndërkohë ka dalur se ka mbetur një numër i konsiderueshëm i aplikantëve pa përfituar, sipas komisionit këta aplikantë nuk i kanë plotësuar kriteret dhe ka dalur ideja që të gjithë këtyre që janë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës dhe studentë t'iu ndahen nga 200.00€, kanë përfituar 279 studentë të nivelit bachelor dhe 37 studentë të nivelit master. Ka pasur raste që kanë bërë ankesa, ato ankesa janë shqyrtuar dhe janë bërë korrigjimet e nevojshme, te ata që ka pasur gabime

teknike pritet t'i marrin mjetet financiare në ndërkohë, nga Drejtoria e Financave kam marrë informatë se deri ne javën e dytë të muajit të ardhshëm të gjithë përfituesit do t'i marrin mjetet financiare. Sa i përket çështjes së renovimit, kur e kam marrë unë detyrën e kam gjetur vetëm një propozim, tani jemi në fazën e grumbullimit të gjendjes aktuale nëpër shkolla dhe ekipet përkatëse, do të dalin me dokumentet përfundimtare, në shkollën 'Mihal Grameno', kemi filluar me renovim dhe do të vazhdojmë me tjerat. Komuna e Fushë-Kosovës, ka vite që përballet me mungesën e normave të reja në sistemin e arsimit, 17 norma nga administrata do të barten në arsim, të gjitha këto norma shfrytëzohen për pozita të domosdoshme, nga analizat që i kemi bërë del se 140 pozita janë të domosdoshme në arsim, përveç kësaj bartje nuk kemi zgjidhje tjetër për momentin. Nëse kemi mundësi që përmes 'Kosova Med', të angazhojmë staf në arsim që është i nevojshëm, ne do ta shfrytëzojmë këtë mundësi. Sa i përket digjitalizmit kam informata, se është në fazat përfundimtare të tenderimit, tre emrat që do të jenë komision në hapjen e ofertave i kam deleguar në zyren e kryetarit. Për pompa termike janë ndarë 1,100,000.00€, është projekt dy vjeçar, ka ndodhë një shpallje publike por në atë shpallje ka dalur se nuk janë të përfshira të gjitha shkollat, dhe është pezulluar, jemi në përgatitje të shpalljes tjetër ku do të përfshihen të gjitha shkollat dhe pas përfundimit të procedurave të fillohet me urgjencë instalimi i pompave termike. Nëse nuk i kam përmbushur pritjet tuaja, më vjen keq, jam i hapur ndaj jush për përgjigje, kur ju e vlerësoni.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Stafi mjekësor z. Laureat Gojnovci, vitin e kaluar në gjashtë mujorin e parë, i kanë marrë mjetet financiare dhe në gjashtë mujorin e dytë nuk i kanë marrë mjetet financiare, kemi tentuar që t'i kompensojmë, por nuk kemi mundur sepse është obligim i prapambetur dhe shkojnë nga kategoria 'Paga dhe Mëditje', nuk na kanë lejuar, ndërsa për këtë vit tani do t'i procesojmë pagesat për gjashtëmujorin e parë. Për bursa të studentëve Valon, secila pagesë që vjen në financa, para se të bëhet certifikimi ajo lëndë është e kompletuar, sepse nuk mundemi më lëshuar pagesë pa qenë e kompletuar.

Kryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. I kam disa pyetje që i kam marrë shënimet, po filloj nga pyetja e Etnikut, që bëri për presion ndaj punëtorëve, nuk e di për çfarë presioni e keni fjalën, presion nuk ka dhe nuk do të ketë asnjëherë ju garantoj. Sa i përket mbeturinave ne e kemi bërë një marrëveshje dhe procesi është përmirësuar dhe do të përmirësohet, edhe më shumë në të ardhmen. Ali, për Planin Zhvillimor Komunal, e kemi dorëzuar me të gjitha vërejtjet e përmirësuara që i ka pasur në kthimin e përgjigjes dhe besoj që shumë shpejtë, do të marrim aprovim dhe pastaj e qesim në dëgjim public dhe shpresojmë që kalon. Për lejen e Xhamisë drejtohuni tek Drejtori për Planifikim Urban me shkrim Laureat, besoj se të kthen përgjigje. Projekti që e kemi për varreza nënkupton një lokacion për gjithë qytetin e Fushë-Kosovës, për varreza të reja, do të thotë se në varrezat ku nuk ka më vend dhe nëpër fshatra, nuk do të zëmë më tokë, do të bëhen me një lokacion të përbashkët për krejtë qytetin e Fushë-Kosovës, kemi prona që i kemi identifikuar ku do t'i dërgojmë varrezat. Ne e kemi bërë një projekt vitin e kaluar me ujësjellsin, ku është bërë kyqja e re, me sa kemi informacion ka problem me furnizim pjesa e lagjes 'Qëndresa', prioritet është qyteti, janë politikat e ujësjellësit që e orientojnë se kush do të ketë përparësi në furnizim. Ju njoftoj se ne kemi marrë një aprovim prej KRU 'Prishtina' e cila ka bërë projektin për fshatrat 'Miradi e Ulët dhe Vragoli' për ujë të pijshëm, rrjetin do ta bëjmë vitin e ardhshëm, kyqja do të bëhet te 'Hib Petroli', aty do të lidhet edhe Miradia e Epërme. Sa i përket vërshimeve ne kemi përfunduar të gjitha procedurat, tani është në dorë të Agjensisë për Menaxhimin e Emërgjencave. Migjen, ngrohjet qendrore do të ketë në qytet, jo nëpër fshatra,

pompat termike do ta rregullojnë temperaturën në katër stinët e vitit. Valon, buxheti do të dal në dëgjim publik dhe ju mund të jepni sygjerimet tuaja, sa i përket 'Britania Home', do të jetë pjesë e projektit të rrugës Nën - Hekurudha dhe shpresojmë që do të zgjidhet problemi me kanalizim dhe vërshime. E kemi rritur mbështetjen financiare për turniret që organizohen në komunën tonë.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë, Aida publikimi i audio-incizimeve është një sfidë që e ka përcjellë këtë Kuvend në të gjitha mandatet, mikrofonët nuk janë funksional për 26 vite, është mbledhja e dytë e mandatit tonë që nuk janë funksional për arsye të dëmtimit të një mekanizmi nga Drejtoria e Bujqësisë, e cila ka pasur një kampanjë në këtë sallë. Për mikrofonë dhe sallë të Kuvendit, po ju informojë se është bërë plani i renovimit të sallës së Kuvendit, është dërguar në prokurim dhe ata duhet të marrin leje nga Ministria, për ta hapur një kod buxhetor të ndarë në dy lote për të renovuar sallën e Kuvendit që është shumë e nevojshme, po shpresojmë që procedurat të fillojnë brenda këtij viti. Aida, po ashtu kërkoi karta të identitetit të asambleistëve, nuk është obligim ligjor, por është kërkesë e anëtarëve të Kuvendit, me shumë të drejtë dhe do ta adresojmë tek IT-ja dhe Drejtoria për Teknologji dhe Inovacion, sa i përket emrave në tavolinë mundemi në mbledhjen e ardhshme t'i sigurojmë. Sa i përket Komisionit për emërimin e rrugëve, kam qenë pjesë e tij mandatin e kaluar dhe nuk ka pasur gadishmëri nga ana e ish-pushtetit për të përfunduar ai process, edhe pse kërkesat e qytetarëve kanë qenë të mëdha, komisoni i ri është formuar vetëm po presin, sepse po vinë kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve dhe po tentojmë t'i grumbullojmë në një vend, pastaj komisioni ta kryejë punën e tij. Dardane, dola në foltore me bërë foton ma të mirë, pyetjen qe e pate për rrethoja të varrezave është cështje problematike dhe e domosdoshme, kodi për rrethoja të varrezave tri vite rresht ka qenë i planifikuar nga Ekzekutivi i kaluar, emërimi i kodit është ndryshuar vit pas viti, ka qenë i parealizueshëm, sepse është i planifikuar keq, ne kemi marrë urgjencën e veprimit për arsye të kërkesave të mëdha të qytetarëve për kanalizim. Në mënyrë që mjetet financiare mos të humbin, do t'i marrim për të rregulluar problemin e kanalizimit, rrethojat e varrezve janë shumë të rëndësishme, por kanalizimi është më urgjent, ky është arsyetimi që unë e jap para jush dhe para banorëve të fshatit Miradi e Epërme. Ne do të bëjmë projekte edhe më të mira për ujin në komunën tonë në të ardhmen, sa i përket turnirit 'Isa Breznica' ka shkuar shumë mirë dhe ka marrë përkrahje nga komuna. Shefat e Grupeve Parlamentare, i kam njoftuar për çdo event sportive.
Kryetari i Komunës: Do të doja që pikat të cilat janë në rend të ditës t'i votoni dhe të kalojnë, se bashku me pikat shtesë, Miradia e Poshtme po bëhet qendër sportive në Fushë- Kosovë, e ka Palestrën e Gjimnastikës, stadiumin pritet ta bëjmë, nëse kalon sot kjo pikë, sa i përket ridestinimit të mjeteve financiare për rrethoja të varrezave, është më urgjente çështja e kanalizimit.
Dardane Sogojeva Shala: Pse mos të rregullohen varrezat në Sllatinë, kur është urgjente dhe nuk ka kosto të lartë, sepse nëse dëmtohet varrezat e dëshmorëve, nuk ka kush merrë përgjegjesi.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Është e vërtetë Dardane, çështja e varrezave është konkrete.

Pika e tretë (3) - Propozim për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky propozim është për kolegun tonë z. Gjelbrim Halili, anëtarë i kuvendit ta plotësoj Komitetin për Politikë dhe Financa, nëse nuk keni diskutim e qesim në votim.
U votua me unanimitet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, gjithsej tridhjetë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për plotësimin e përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa' dhe mori:

VENDIM

1. Për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7 të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarin e ri: z. Xhelbrim Halili nga partia Aleanca.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Politikë dhe Financa, është shqyrtimi i të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore'. Hap diskutimin.

Kosovar Ademi: E mbështesim këtë propozim për aprovim.

Laureat Gojnovci: Ky problem është evident, është për tu vlerësuar tentativa për t'i bërë zgjidhje nxënësve, por kjo mënyrë po e vlerësojmë që nuk është në rregull, sepse është e paprecedent dhe nuk dihet opinioni i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, se si do ta kthejë këtë vendim. Ne si Grup Parlamentarë, do ta përkrahim nëse do të ishte ndarë një pjesë e mjeteve financiare, për të rekrutuar një staf për një periudhë gjashtë mujore, sepse me rëndësi është që nxënësit të kenë mësuesit, e mandej t'i bëjmë presion Ministrisë që ato t'i inkorporojë në norma të arsimit, e jo në këtë mënyrë, sepse as Administrata Komunale nuk ka mjaftueshëm staf.

Migjen Kolshi: Ne si Grup Parlamentarë në parim e mbështesim këtë pikë, sepse në të kaluarën ka ndodhur e kundërta. Mendoj se arsimi ka nevojë më shumë për norma se komuna dhe besoj se Ministria do ta aprovoj.

Ali Ismaili: Kësaj pike po i mungon elaborimi pak më i detajuar, nuk është shkruar mirë propozimi, po i mungon pjesa, a kemi më marrë mësimdhënës klasor apo për lëndë të caktuara, mirëpo për shkolla dhe xhamia, gjithmonë do i mbështesë.

Driton Ademi: Formulimi i pikës së rendit të ditës bjen në kundërshtim me përmbajtjen e materialit, që ne e kemi si asambleistë, kur flitet për rregullim, harmonizim të oragnizatës buxhetore atëherë ne flasim për komunën, që kërkesa është e drejtorisë kështu që nëse flasim për lëvizje të stafit, atëherë kjo nuk ka të bëjë me Kuvendin, atë e rregullon Ligji për zyrtar publik, kështu që po bjën ndesh formulimi i pikës së rendit të ditës me materialin që e kemi pranuar. Kur flasim për buxhetin e vitit 2027, të planifikohet mirë stafi duke pasur parasysh numri e banorëve, a pranon Ministria apo jo është çështje tjetër, kemi nevojë për norma, kështu që po e them prapë që rendi i ditës të jetë në përputhje me material.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, po e qesim në votim këtë propozim.

U votua me: njëzet vota 'për', asnjë votë 'kundër' asnjë abstenim.
Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Kërkesës së Kryetarit të Komunës lidhur me rregullimin dhe harmonizimin e numrit të normave të lira të punës në kuadër të Organizatës Buxhetore, me qëllim të mbulimit të mungesës së normave në institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm, sipas kërkesës së arsyetuar të Drejtorisë së Arsimit.
2. Kuvendi i Komunës e obligon Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorinë e Arsimit, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për bartjen e 17 (shtatëmbëdhjetë) pozitave të normave të lira ndërmjet programeve buxhetore, sipas tabelës së bashkëngjitur, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Bartja e pozitave realizohet si në vijim:

2.1 Zyra e Kryetarit - 1 pozitë;
2.2 Administrata dhe Personeli - 3 pozita;
2.3 Shërbimet Publike - 3 pozita;
2.4 Zyra Komunale për Komunitete - 3 pozita;
2.5 Zhvillimi Ekonomik - 1 pozitë;
2.6 Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale - 1 pozitë;
2.7 Kultura, Rinia dhe Sporti - 2 pozita;
2.8 Arsimi dhe Shkenca - 1 pozitë;
2.9 Drejtoria për Infrastrukturë - 2 pozita.

3. Bartja e pozitave realizohet pa rritur numrin e përgjithshëm të normave të miratuar në Organizatën Buxhetore të Komunës së Fushë-Kosovës. Numri i përgjithshëm i pozitave të miratuara është 1124, ndërsa bartja përfshin vetëm 17 pozita, që përbëjnë rreth 1.5% të numrit të përgjithshëm të pozitave. Ndryshimi bëhet me qëllim të harmonizimit të strukturës së normave për mbulimin e nevojave prioritare të Drejtorisë së Arsimit dhe sigurimit të funksionimit efikas të sistemit edukativo-arsimorë.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar-Qershor 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për periudhën Janar- Qershor 2026, tani e ftoj Drejtorin për Buxhet dhe Financa të na paraqet përmbajtjen e materialit.

Drejtori për Buxhet dhe Financa: Raportin Financiar e keni marrë të gjithë, është raport financiar për peridhën janar- qershor 2026, conform Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Statutit të Komunës të vitit 2012. Ky raport është përgatitur në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik, buxheti i aprovuar në Kuvendin e Komunës ka qenë 26,803,585.00€, me bartjen e të hyrave e cila ka ndodhur janë bartur edhe 4,006,082.00€, pra buxheti është rritur në vlerë 30,819,947.00€. Në periudhën e gjashtë mujorit të parë janë alokuar 23,353,442.00€, ndërsa janë shpenzuar 9,108,119.00€, shpenzimi total gjatë kësaj periudhe është 39%, me alokim. Nga granti i përgjithshëm janë alokuar 17,249,845.00€, janë shpenzuar 8,628, 544.00€, ose 50% e shumës së mjeteve të alokuara. Detajet më të hollësishme i keni në material.

Kosovar Ademi: Pajtohemi më këtë pikë të rendit të ditës, meqë në shumë kode kemi zvogëlim të shpenzimeve.
Laureat Gojnovci: Kjo pikë e rendit të ditës, mund të elaborohet por nuk mund të arsyetohet, i keni rritur mallërat dhe shërbimet, në krahasim me vitin 2025, kjo është kategoria që mund të keqëpërdoret më së shumti. Një milionë janë investime kapitale, me projektet që po kthehen në prokurim 50% e granteve do të shkojë në suficit, prej këtij një milioni, sa janë projekte të ish/pushtetit që po i paguani, cilat projekte tjera i keni përfunduar që ju ka përmbushur 10%? Jemi në fund të muajit korrik, kur planifikohet të punoni me projekte tuaja, renovimi i shkollave do të mbetet pa përfunduar, sepse në shtator nxënësit kthehen në shkollë. Te shpenzimet e Zyrës së Kryetarit është vlerë e madhe, kisha dashur të kemi një auditor në Kuvend dhe t'i themi auditoj këto pagesa. Te shërbimet kulturore në bazë të raportit është vetëm një automjet, sepse të regjistrimi i automjeteve është shuma 75.00€, sigurimi i automjetit 194.00€, komplet kjo është shpenzim i sigurimit, por thotë mirëmbajtja dhe riparimi i automjetit në të është 1,512.00€, me sa e dijë unë shërbimet kulturore kanë një automjet Golf 4, e cila komplet me ble nuk e ka atë çmim. Drejtor, tregom sa projekte të juaja i keni paguar me këtë buxhet?
Valon Murseli: Një pjesë e këtij raporti u përmbledh nga Laureati, shpenzimet për mallëra dhe shërbime janë 720,000.00€ më shumë se viti i kaluar, të hyrat vetanake për 755,000.00€ më pak, investimet kapitale 9%, shpresojmë të rriten deri në fund të vitit, sepse ka nevojë Fushë-Kosova për projekte kapitale. Shpenzimet për udhëtime janë rritur për 58%, shpenzimet te Zyra e Kryetarit, pse ky dallim diku 28%, te Zyra e Kuvendit ka shpenzim prej 48% më shumë, te telefonia mobile 38% shpenzim më shumë, furnizimi me pije, ushqim dhe dreka zyrtare 16% me shumë shpenzim, pse? Shpenzim që është më pak është shpenzimi për përfaqësim brenda vendit, që ka dallim të madh nga viti 2025, që e vlerësoj pozitive.
Ali Ismaili: Shqetësuese për mua në gjashtë mujorin e parë mbeten investimet kapitale, ku nga 11 milion kemi shpenzuar vetëm 1 milion, kam frikë se do të ngelen shumë në suficit dhe jemi keq. Ajo që pashë në raport Drejtoria e Kadastrit kishte shpenzuar derivate 400.00€, krahasuar me Drejtorinë e Inspektoriatit që është 900.00€, kjo i bjen që Drejtoria e Kadastrit ka shpenzuar shumë, gjithashtu shpenzime të mëdha në shkolla për energji elektrike. Shtesa për punë jashtë orarit kanë marrë shumë, edhe zyra e kuvendit, inspeksioni dhe bujqësia 18,843.00€ shërbime teknike, ka edhe shumë çështje tjera që i kam nënvizuar.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar-Qershor 2026.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim Propozimin për shqyrtimin e Raportit të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën Janar- Qershor 2026, është informatë e përgjithshme, materialin e keni pranuar, jeni të njoftuar për gjithë çka, po e hapim diskutimin.
Kosovar Ademi: Nuk kemi të shtojmë të gjitha shënimet janë pjesë e raportit të punës së Kuvendit, për këtë periudhë raportuese.
Laureat Gojnovci: Sa i përket punës së raportit të Kuvendit, ajo që e ka karakterizuar këtë Kuvend, gjatë këtyre muajve është mbarëvajtja jo e rregullt për arsye të sjelljes jo korrekte nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Ky Kuvend ka marrë vendime që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, shqetësuese është se Ministritë kompetente, nuk kanë marrë masa për anulimin e këtyre

vendimeve, gjë që e humb kuptimin e funksionimit të një shteti ligjor brenda Republikës së Kosovës, ka vendime që nuk e kanë marrë miratimin e ministrisë së linjes por i keni kaluar në heshtje, sot ka pasur një mbarëvajtje në Kuvend dhe uroj që kjo të vazhdojë.

Migjen Kolshi: Nga ana e Grupit tonë parlamentarë e keni një notë të shkelqyeshme kryesues, sepse keni qenë korrekt. brenda këtyre muajve, ky Kuvend ka prodhuar fyerje, sharje, etiketime të ndryshme e tjera, kritikat që i kemi bërë ne asambleistët kanë qenë shumë korrekte dhe pasi ka përfunduar Kuvendi, e kemi parë veten nëpër portale, faqe të ndryshme të cilat kanë qenë të inicuara nga ky Kuvend. Uroj që ky Kuvend të vazhdojë mbarë punën e tij.

Ali Ismaili: Kuvendi nuk ka pasur transparencë, është duke u shkelur Ligji për Vetëqeverisje Lokale, sepse nuk ka pasur publikimi të video-incizimeve asnjëherë. Duhet të bëhet rregullimi i sallës dhe mikrofonëve, të përgëzoj kryesues për themelimin e të gjithë komiteteve dhe kanë filluar funksionin e tyre. Është mirë të na dorzohet një tabelë e vendimeve, sa vendime sa janë miratuar nga ministria, sa janë kthyer, sa kanë kaluar në heshtje e tjera. Kur kemi folur diçka këtu kemi dal në portale si hoxhollar milionera, jemi bërë me X në portale, jemi etiketuar në forma të ndryshme dhe është mire ky Kuvend të reagojë, sepse nuk është mirë, ne kritikojë për mundësinë që të bëhet qyteti më i mirë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nevoja është që të rregullohet salla dhe zërimi, 71 vendime janë marrë në Kuvend, ka qenë punë e mrekullueshme dhe ju falenderoj secilin nga ju, ne si Kuvend e dënojmë gjuhën e urrejtjes që shfaqet në portale dhe është e papranueshme për ne, gjithmonë do të jemi në mbështetje të anëtarëve të Kuvendit.

Pika e shtatë (7) - Propozimi për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026'. Hap diskutimin.

Kushtrim Mirena: Si asambleistë kur kam parë se shuma prej 200,000.00€, është ndarë për rrethojat e qytetit më është dukur absurde, kur e dimë se aty kanalizimi, nuk është i rregulluar, nëse këto mjete financiare ishin ndarë për renovimin e varrezave të martirëve do të ishte në rregull. Ne si Grup Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim këtë ridestinim të mjeteve financiare, sepse ankesat e qytetarëve janë kryesisht për kanalizim. Sa i përket varrezave të martirëve gjendja e tyre është e mjerueshme, jemi duke punuar në këtë drejtim, kemi pasur takim me Agjensionin Memorial të Kosovës dhe na është premtuar, se do të investohet në varreza të martirëve, nga komuna është kërkuar të bëhet një projekt i cili është realizuar, është dërguar në Agjension dhe presim të përfundojë shumë shpejtë, nëse nuk përfundon nga Agjensioni shpresoj që ne si komuna ta përfundojmë atë projekt. Ne si Lëvizje Vetëvendosje, e përkrahim këtë propozim, sepse nevojat për kanalizim janë të mëdha.

Laureat Gojnovci: Ka shumë arsye pse nuk duhet të kaloj ky vendim, sepse mund të ketë kërkesë nga banoret e Miradisë së Epërme, për t'i rrethuar varrezat, secili ridestinim i buxhetit nënkupton rishikim të buxhetit, pse nuk e keni rregulluar çështjen e kanalizimit me bartje, kur ka pasur mjete financiare të mjaftueshme, por duhet të shuhet një kod për të mbushur një kod tjetër, gjë që është e jashtëligjshme?

Migjen Kolshi: Dua të lidhem te rishikimi i buxhetit, ka rënë rëndësia e numrave në Kuvend për arsye të dy komunave Gjilanit dhe Podujevës, të cilat nuk i kanë pasur numrat në Kuvend dhe me

shumicë të thjeshtë i kanë kaluar vendimet. Sa i përket këtij propozimi, 200,000.00€, për investime kapitale kodi 22850 për ndërtimin e kanalizimit nëpër fshatra z. Kushtrim Mirena, tani shumën prej 921,266.06€, e keni buxhet për 2026 për këtë kod, tani po shtohen edhe 300,000.00€, mendoj që është shumë. Rrethimi i varrezave është i domosdoshëm në fshatin Miradi, Sllatinë, ne si Grup Parlamentarë i Partisë Demokratike të Kosovës, gjithmonë e kemi përkrahur kur ka ardhur ai propozim, unë personalisht nuk besoj se ka nevojë më shumë për kanalizim se sa për rrethoja, andaj ne si Grup Parlamentarë nuk e përkrahim këtë propozim.

Ali Ismaili: Në fillim e kundërshtova këtë pikë, pyeta nëse këto mjete financiare kanë ekzistuar deri tani, pse nuk është hapur tenderi dhe pse nuk janë rregulluar deri tani rrethojat e varrezave në Miradi, Sllatinë dhe Fushë-Kosovë? Një nga kërkesat kryesore të mia ka qenë kjo, arsyeja pse qytetarët e Miradisë së Epërme, nuk po bëjnë kërkesa, është sepse e dinë se janë ndarë mjetet financiare për rrethim nga Ekzekutivi i kaluar dhe vetëm presin të përfundojnë. Personalisht me banorë kemi pritur te Zyra e Kryetarit për të rregullar këtë pjesë, pajtohem me ju që prioritet janë varrezat, e falenderoj kryetarin publikisht që tha, se të gjitha varrezat e Komunës së Fushë-Kosovës, do t'i bëjmë në një vend. Kemi pasur mundësin t'i bëjmë këto rrethoja, nuk qëndron fakti se ka shumë kërkesa për kanalizim, se sa për rrethoja, por nëse drejtori e sheh më të arsyeshme, që të rregullohet kanalizimi është në rregull, une kam kërkuar që të rregullohen ato rrethoja sepse kemi problem me varreza, unë jam kundër këtij propozimi. A më shumë rëndësi ka kanalizimi apo arsimi, pse nuk i marrim 300,000.00€, për t'i rregulluar tualetet në shkolla, është gabim të kthemi prapa kur është një propozim i mirë kush do qoftë, që e ka lënë duhet të përkrahet.

Etnik Berjani: Unë kërkoj nga Hoxha si imam në Miradi të Epërme, nga t'i z. Vlonjat si kryesues që vjen nga Miradia e Epërme dhe nga të gjithë ju mos e votoni këtë propozim, ka nevojë për kanalizim por ka pasur mundësi, që të rregullohet me bartje, po doni me mbyll kodin për rrethoja të varrezave, mos gjeni arsyetime, ka nevoja të shumta edhe Miradia e Epërme, edhe Fushë-Kosova, mirëpo kodi është i gatshëm dhe duhet të vazhdohet, ju kërkojë të mos e votoni largimin e kodit për rrethojën e varrezave.

Kosovar Ademi: Deshta të ndërlidhem me Etnikun, a keni sinqerisht, që po doni t'i rrethoni varrezat, apo e keni vetëm si temë, ne jemi Ekzekutiv edhe nëse gabojmë, gabojmë për vetën tonë, ne e kemi planifikimin tone, nuk mundemi me vepruar me instruksione tuaja.

Ali Ismaili: Pajtohem me Kosovarin, a keni mundësi të më ndihmosh, me i lanë 50,000.00€, në këtë kod që këta nesër t'i hapin procedurat për t'i rrethuar varrezat në Miradi të Epërme, kërkoj që ky propozim të hedhet në votim.

Rrahim Tërnava: Ne kemi përgjegjësi që ta dërgojmë këtë komunë përpara dhe të jemi shembull për gjeneratat e ardhshme. Bota është duke shkuar shumë përpara me teknologji, kurse ne kemi mbetur prapa me gilindera për 26 vite, në vend që të propozojmë, në pika të buxhetit të shtohen Qendra innovative, me hap vende të punës, ide për biznese dhe rinia të mbesin në Fushë-Kosovë. Unë kam një propozim për juve asambleistë, që të bëhemi bashkë dhe të propozojmë projekte më të mëdha, të hapim vende të punës për gjeneratat e reja, sepse janë mundësitë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e qesim në votim propozimin.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi 'Propozimin për ridestinimin e mjeteve financiare për shpenzim në vitin 2026' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e ridestinimit dhe rishpërndarjes së mjeteve financiare nga projekti capital 'Ndërtimi i rrethojave me infrastrukturë përcjellëse në varrezat e qytetit të Fushë-Kosovës, fshatrave 'Miradi e Epërme' dhe 'Sllatinë e Madhe' - Kodi i projektit Nr. 20819, në shumën e përgjithshme prej 300,000.00 €, ridestinohen dhe rishpërndahen për shpenzim në vitin 2026 nga kategoria ekonomike e projekteve kapitale, në kategori të tjera ekonomike në projekte kapitale dhe shpenzime për komunali si vijon:

1.1 Shuma e mjeteve financiare prej: 200,000.00 € (dyqind mijë euro) barten në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale, tek Kodi i projektit Nr. 20850 - 'Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat: Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Henc, Graboc, Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Pomozotin, Harilaç, Vragoli, Miradi e Ulët, Miradi e Lartë, Lismir, Kuzmin dhe në qytet – Fushë-Kosovë: Bresje, Nakaradë, lagjet '028' dhe '029' dhe

1.2 Shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00 € (njëqind mijë euro) barten në kategorinë ekonomike të Shpenzimeve Komunale, tek kodi i programit buxhetor Infrastruktura Publike Nr. 18162.

2. Mjetet e ridestinuara do të shfrytëzohen për realizimin e kërkesave të qytetarëve për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit si dhe mbulimin e faturave bazë të borxheve të trashëguara për shpenzime komunale për institucionet publike të komunës.

Pika e tetë (8) - Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme, ftojmë Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ta paraqesë propozimin.

Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport: I nderuar kryesues, të nderuar asambleistë, propozojë të ndahet hapësira për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme, është hapësirë 212ha dhe stadiumi parashikohet të ndërtohet sipas standardeve të Federatës së Atletikës Europiane, do të jetë i gatshëm për lojërat mesdhetare 'Prishtina 2030', është investim i jashtëzakonshëm i Federatës së Atletikës së Kosovës, tani Fushë-Kosova do t'i ketë dy terrene sportive, pres nga ju ta votoni për të mirën e fshatit dhe Fushë-Kosovës.

Kosovar Ademi: E mbështesim propozimin.

Laureat Gojnovci: Sa herë të sjellni propozime të tilla drejtor do t'i përkrahim gjithmonë.

Migjen Kolshi: E mbështesim propozimin.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Meqenëse nuk ka diskutime tjera, po e qesim në votim propozimin.

U votua me unanimitet nga anëtarët e kuvendit, gjithësej njëzet e tetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim e aprovoi 'Propozimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës në fshatin Miradi e Poshtme' dhe mori:

VENDIM

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 1359, të datës 28.07.2026 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit të Atletikës, ndahet sipërfaqja në fshatin Miradi e Poshtme, në pronën publike komunale të përshkruar në paragrafin 2 të këtij vendimi.

2. Ndërtimi i Stadiumit të Atletikës do të realizohet në pronën publike komunale, përkatësisht në njësinë kadastrale me numër P-72514027-00196-5, të lëshuar me datën 28.07.2026, në sipërfaqen të përgjithshme prej: S = 21211.91 m² në vendin e quajtur 'Livade Pashnjak', në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme.
3. Lokacioni i caktuar dhe ndarja gjeodezike sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të shfrytëzohet për projektimin dhe ndërtimin e stadiumit sipas standardeve të përcaktuara nga Federata e Atletikës së Kosovës dhe Federata Botërore e Atletikës, me qëllim të zhvillimit të sportit, organizimit të garave vendore e ndërkombëtare, si dhe aktiviteteve rekreative.

Pika e nëntë (9) - Të Ndryshme.
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në qoftë se nuk ka dikush të shtojë ndonjë qështje te 'Të Ndryshme', konstatoj se është mbyllur mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 14:20 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani